REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 309, Datë 26.10.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË "SHPERDHAZA - ENERGJI" SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 40, pika 2, gërma "a", 41, pika 1, gërma "a", dhe 136, pika 2 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*"; neneve 4, pika 1, gërma "a", 5, pika 1, gërma "a" dhe 10, pikat 1 dhe 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma "a" të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3001/4 prot., datë 26.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "SHPERDHAZA - ENERGJI" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"*,

Konstatoi se:

- Shoqëria "SHPERDHAZA - ENERGJI" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3001 prot., datë 07.10.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në kuadër të projektit për ndërtimin e hidrocentralit "Kacinar".
- Nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se, në shkresën përcjellëse shoqëria i referohej projektit "Kacinar" dhe Kontrata nr. 472 rep., nr. 290 kol., datë 21.09.2015, të formës "BOT" *"Për ndërtimin e Hidrocentralit "Kaçinar"*, e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), parashikonte ndërtimin e katër HEC-eve, "Arrëz", "Kaçinar", "Simon" dhe "Shpërdhaza", ndërkohë që shoqëria, në shtojcën 2 të aplikimit për licencim, kishte deklaruar të dhënat teknike vetëm për HEC-in "Arrëz", me kapacitet 1613 kW, si dhe kishte kryer pagesën për shqyrtimin e aplikimit vetëm për një central.
- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mailit të datës 16.10.2026 iu kërkua shoqërisë që të saktësonte nëse kërkonte licencimin vetëm për HEC-in "Arrëz" apo për të katër HEC-et, pasi në këtë rast duhet të kryente pagesën shtesë prej 750,000 lekësh për tre centralet e tjera, referuar përcaktimeve të Aneksit A të rregullores. Gjithashtu, iu bë me dije se, në mungesë të

saktësimeve dhe/ose pagesës përkatëse brenda afatit, aplikimi do të shqyrtohej vetëm për HEC-in "Arrëz", mbi bazën e dokumentacionit të depozituar.

- Me e-mailin e datës 19.10.2026, shoqëria ka sqaruar se, nga katër hidrocentralet e përfshira në kontratën e koncesionit nr. 472 rep., nr. 290 kol., datë 21.09.2015, vetëm HEC "Arrëz" ka përfunduar plotësisht ndërtimin, ndërsa HEC-et "Kaçinar", "Simon" dhe "Shpërdhaza" ndodhen ende në proces ndërtimi. Për rrjedhojë, shoqëria ka konfirmuar se aplikimi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike përfshin vetëm HEC "Arrëz", ndërsa për hidrocentralet e tjera do të paraqesë aplikime të veçanta pas përfundimit të ndërtimit të tyre.

- Për gjithë sa më sipër vlerësohet të vijohet me shqyrtimin e aplikimit për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Arrëz", me kapacitet të instaluar 1,613 kW.

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, b dhe d).
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave (a dhe c).
- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (b, d e, dhe f).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria "SHPERDHAZA - ENERGJI" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE-n Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim-Operim-Transferim) *"Për ndërtimin e Hidrocentralit "Kaskada kacinar"* nr. 472 rep., nr. 290 kol., datë 21.09.2015, amenduar me Kontratën shtesë të koncesionit nr. 252 rep., nr. 132/2 kol., datë 16.02.2018 dhe Kontratën shtesë të koncesionit nr. 3000 rep., nr. 830/1 kol., datë 08.09.2023;
- Ka marrë miratimin për lidhjen e HEC-it "Arrëz", me kapacitet 1.613 kW, nëpërmjet shkresës së OSHEE, 15285/3 prot., datë 13.07.2017;
- Është pajisur me "Leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor" nr. 7 prot., datë 10.06.2024, e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU) Mat, miratuar me Vendim të Këshillit të Basenit Ujor Mat nr. 8, datë 21.05.2024, për subjektin "SHPËRDHAZA-ENERGJI" sh.p.k, për

aktivitetin e prodhimit hidroenergjie (HEC Arrëz, Kacinar, Simon, Shpërdhasë). Afati i vlefshmërisë së kësaj leje është për të gjithë periudhën e koncesionit.

- është pajisur me Deklaratë Mjedisore, me nr. 3794, datë 09.06.2016, me nr. Identifikimi 314 dhe vendimi nr.32 për Personin Juridik "Shperdhaza Energji" sh.p.k. për të zhvilluar projektin: "Ndërtim i Kaskadës Kacinar", me fuqi të instaluar 6,85 MW, e po ashtu me Vendim për VNM Paraprak, me nr. 1728 prot., datë 02.04.2019, nr. Identifikimi 304, Vendimi 17, për Personin Juridik "SHPERDHAZA - ENERGJI" sh.p.k. për të zhvilluar projektin: "Ndërtim i Kaskadës Kacinar", me kapacitet total të instaluar 6.850 kW

Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me informacionin/dokumentacionin si vijon:

NENI 9
Formati dhe dokumentacioni për aplikim
Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë
Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma "b":** vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), për administratorin e shoqërisë.
- **gërma "c":** marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë ortake për stafin organizativ dhe teknik.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma "b":** informacion për modalitetin e financimit/ndërtimit të HEC-it.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1: Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma "a":** të dhëna të përditësuara mbi datën e fillimit të operimit, për shkak se data 01.11.2026 e parashikuar nga shoqëria nuk është më e arritshme për shkak të afateve procedurale të licencimit.
- **gërma "e":** informacionin/raportet e depozituara në AKM për fillimin/ecurinë e punimeve të HEC-it, në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së Paraprake.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "SHPERDHAZA - ENERGJI" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Arrëz", me kapacitet të instaluar 1,613 kW, me vendndodhje në ujërat e lumit Shpërdhazë, Komuna Kaçinar, Rrethi Mirditë.

2. Shoqëria “SHPERDHAZA - ENERGJI” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe informacionin përkatës të kërkuar gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* të ndryshuar.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “SHPERDHAZA - ENERGJI” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI